



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.609/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Milena Đerić dhe Afijete Sada- Gllogjani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik G.I.Srpski Opstanak me seli në Mitrovicën e Veriut paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut për shkak të mbulimit dhe dëmtimit të posterave të subjektit politik G.I.Srpski Opstanak për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pasafatshme ankesa Anr.609/2021 e parashtruar nga subjekti politik G.I.Srpski Opstanak me seli në Mitrovicën e Veriut e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike- mbulimi dhe dëmtimi i posterave për qëllime të fushatës zgjedhore në Komunën e Mitrovicës Veriore.

A r s y e t i m

Me datën 06.10.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik G.I.Srpski Opstanak me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën pretendon se me datën 05.10.2021 nga ora 17:00 deri në ora 20:00, ka bërë vendosjen e 500 posterave në hapësirat e parapara dhe të lejuara për vendosjen e tyre, mirëpo të nesërmen në 18 prej këtyre 20 lokacioneve ku janë vendosur këta poster janë dëmtuar dhe ka theksuar se rasti është paraqitur edhe në Polici me nr. 2021-SA-193.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjektit politik Lista Srpska, me seli në Mitrovicën e Veriut është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, dhe ka kërkuar që subjektit politik Srpska Lista të ndëshkohet sepse nga fotografitë shihet qartë që të gjitha pllakatet e tyre janë të mbuluara me pllakatet e subjektit politik Srpska Lista.

Lidhur me këtë ankesë parashtruesi i saj ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi si dhe dy lidhje të ëb faqeve (portale) lidhur me shkeljet e supozuara.

Me datë 06.10.2021 PZAP-i, i ka parashtruar subjektit politik Srpska Lista kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën e paraqitur me të cilën ka kërkuar që e njëjta të përgjigjet deri me datë 07.10.2021 në ora 12:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2021, subjekti politik Srpska Lista këto pretendime i konsideron absolutisht si të pabaza duke theksuar se nuk është e diskutueshme që fotografitë e paraqitura tregojnë materialin e shkatërruar të këtij subjekti politik, gjë të cilën e kritikojnë por nga ana tjetër theksojnë se ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë për të mbështetur pretendimin e tij se posteret janë grisur nga subjekti politik Srpska Lista. Mbi të gjitha, mes fotografive të paraqitura, më saktë në fotografinë me numër 1633529920720 të cilën theksojnë së e kanë bashkangjitur krahas përgjigjes në kërkesë mund të shihet qartë se persona të panjohur kanë shkatërruar edhe materiale zgjedhore të subjektit tonë. Më tutje në përgjigjen e paraqitur subjekti politik Srpska Lista theksojnë se procedurat hetimore lidhur me shkatërrimin e materialit zgjedhor vazhdojnë dhe institucionet kompetente nuk dhanë përgjigjen e tyre në pyetjen se cilët ishin autorët e dëmtimit të këtyre materialeve, kjo është absolutisht e papranueshme që faji t'i atribuohet subjektit tonë politik, ndërsa faji nuk është vërtetuar në mënyrë të pakundërshtueshme.

Po ashtu në përgjigjen në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Srpska Lista theksohet se shkelja e rregullave është bërë nga IQ Srpski Opstanak, sepse ky subjekt politik e vendosi materialin e tij promovues në hapësirat reklamuese në pronësi të institucionit arsimor (fotografia me nr. 1631529930710), gjë që është e dënueshme dhe nuk është në përputhje me rregullat. Përgjigjes në ankesë i kanë bashkangjitur edhe dy fotografi të printuara.

Në fund të kësaj përgjigjeje në kërkesë subjekti politik Srpska Lista i ka propozuar PZAP që të miratojë përgjigjen ndaj ankesës si të bazuar dhe të hedhë ankesën si të pa bazuar.

Duhet të theksohet se ankuesi është eliminuar nga procesi zgjedhor për shkak të dënimit nga gjykata kompetente, që flet mjaftueshëm për besueshmërinë e ankuesit, thuhet në përgjigje.

PZAP-i, me qëllim që të hetohet rasti në fjalë i është drejtuar Policisë së Kosovës me datë 06.10.2021, lidhur me rastin.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik G.I.Srpski Opstanak me seli në Mitrovicën e Veriut, kundër subjektit politik Srpska Lista, me seli në Mitrovicën e Veriut, e paraqitur me datë 06.10.2021, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” i cili përcakton se: *“Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”*.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në veçanti Raportit Policor të datës 06.10.2021, paraqitur nga Stacioni Policor në Mitrovicën e Veriut me nr.2021-SA193 vërteton faktin se shkelja e pretenduar nga ankuesi ne ankesë ka ndodhur me datë 03.10.2021, dhe jo ashtu siç pretendon parashtruesi i ankesës me datë 05.10.2021. Ky fakt vërtetohet nga përshkrimi në raportin policor të lartcekur ku citohet se: “me datë 03.10.2021, rreth orës 14.30, në Stacionin Policor në Mitrovicën e Veriut, është paraqitur pala Dushan Milionovi, i cili është prezantuar si përfaqësues i partisë politike “G.I.Srpski Opstanak”, me seli në Mitrovicën Veriore dhe sipas tij, ai me një grup bashkëpunëtoresh me datë 02.10.2021, nëpër shumë vende nëpër qytet kanë vendosur disa banderola me qëllim të prezantimit të partisë së tyre lidhur me fushatën parazgjedhore të zgjedhjeve të datës 17.10.2021”. Nga ky raport policor rezulton fakti se parashtruesi ankesën e ka dorëzuar në PZAP me datë 06.10.2021 ndërsa shkelja e supozuar në ankesë ka ndodhur me datën 03.10.2021 andaj ky afat kohor për paraqitjen e ankesës ka rrjedhur që nga momentit kur parashtruesi i ankesë ka vërejtur se është shkaktuar shkelja, që do të thotë se ankuesi, ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” e PZAP-it.

Paneli pasi që vërtetoi faktin se ankesa e parashtrua nga subjekti politik G.I.Srpski Opstanak me seli në Mitrovicën e Veriut, është e pas afatshme, i njëjti nuk u lëshua në vlerësimin e çështjes meritore.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat, nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A.nr. 609/2021 me datë 08.10.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 115 paragraf 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.